

Nr. Prot. 060/B/17**VENDIMI Nr. 1060****Për****‘Caktimin e bllokut numerik Jo-Gjeografik (mobil) nga seria****(0)45 7xx xxx****për përdorim nga Operatori Telekom i Kosovës Sh. A.**

Në mbështetje të nenit 45, paragrafi 1) dhe 3), nenit 58, nenit 59, paragrafi 1) dhe neni 79, paragrafi 1) dhe 2) i Ligjit Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*); Rregullores Nr. 32 për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës (*Ref. Nr. Prot. 038/B/17*), nenit 4), nenit 5), nenit 6), nenit 8) dhe nenin 16) (*tutje referuar si - Plani i Numeracionit*); në bazë të kërkesës së operatorit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, “Telekomi i Kosovës” Sh.A. (*tutje referuar si - Telekom i Kosovës*) të datës: 11/10/2017 (*Ref.Nr.Prot.702/2/17*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i Autoritetit në përbërje prej:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi | Kryetar |
| 2) z. Bahri Anadolu | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari | Anëtar |
| 4) z. Nijazi Ademaj | Anëtar |

në mbledhjen e 22-të me radhë të mbajtur më datë 18 Tetor, 2017 pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, rekomandimit të paraqitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) dhe Departamenti Ligjor (DL), vendosi si më poshtë:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e operatorit **Telekomi Kosovës** për caktimin e bllokut numerik jo-geografik mobil të specifikuar si më poshtë:

Prefiksi (NDC)	Fillimi i Bllokut	Fundi i Bllokut	Madhësia e Bllokut
(0)45	700 000	799 999	100,000
Gjithsej			100,000

- II. Tarifimi për bllokun numerik të caktuar në pikën I) të këtij vendimi do të bëhet në bazë të nenit 8 të Planit të Numeracionit. Tarifimi për caktim të numeracionit është 0.06 € për numër/vit.
- III. Pagesa vjetore për bllokun numerik të caktuar në pikën 1) të këtij vendimi do të bëhet nga Telekom i Kosovës brenda periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal.
- IV. Blloku numerik i caktuar në pikën I) të këtij vendimi do të shfrytëzohet për nevoja dhe ofrim të shërbimeve të telefonisë mobile nga përdoruesit e Telekomit të Kosovës.
- V. Në rast se numrat e caktuar përdoren për qëllime, të cilat nuk janë paraparë në pikën IV) të këtij vendimi, atëherë numrat e caktuar do të revokohen.
- VI. ARKEP rezervon të drejtën që në të ardhmen të ndryshojë këtë vendim, nëse e sheh të arsyeshme, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe për çdo ndryshim në lidhje me vendimin, me kohë do të informojë palët e interesit.
- VII. Vendimi nr. 381 për Rezervimin e Serisë së Numeracionit Jo-Gjeografik - mobil (0)45 7xx xxx për përdorim të mëtutjeshëm nga Operatori Virtual - Dardafon.Net LLC' (Nr. prot. 026/B/13) shfuqizohet në tërësi.
- VIII. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Me datën 11/10/2017 Telekom i Kosovës ka paraqitur kërkesë për për ndërrimin e pronarit me të drejtë të përdorimit të serisë numerike 045 7xx xxx, seri kjo e caktuar për përdorim të Dardafon.net LLC me Vendimin nr. 1032 të ARKEP.

Telekomi i Kosovës dhe Dardafon.net LLC kanë njoftuar ARKEP se përkundër angazhimit maksimal të dyja ekipeve teknike (MNO dhe MVNO) nuk kanë arritur t'i diferencojnë numrat e MVNO dhe MNO në rangun 045 7xx xxx, si dhe rreth 3% e përdoruesve të këtij rangu janë në shfrytëzim nga përdoruesit e Telekomit të Kosovës. Duke pas parasysh vështërsitë e paraqitura në implementimin e këtyre numrave që të dyja palët janë dakorduar që MVNO të aplikojë për një rang tjetër të numeracionit. Prandaj, Dardafon me dt. 20/09/2017 ka aplikuar për zëvendësimin e numeracionit nga seria ekzistuese në serinë 046 1xx xxx.

Ligji, respektivisht neni 59, paragrafi 1) përkufizon se numrat, seritë numerike, mund të përdoren vetëm në bazë të vendimit të Autoritetit. Rrjedhimisht asnjë ndërmarrës i përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, operator dhe/apo ofrues i shërbimit, ose shfrytëzues tjetër nuk mund të përdorë një numër-at apo blloqet/seritë numerike përveç nëse dhe derisa ARKEP t'i caktojë apo vazhdojë autorizimin për përdorimin e numrave të tillë.

Në bazë të Planit të Numeracionit, nenit 16, seria 4x e numrave është e përcaktuar si seri e numeracionit jo-gjeografik për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile.

Në bazë të Planit të numeracionit neni 16 paragrafi 5 përcaktohet se: Blloqet e numrave për shfrytëzim nga ofruesit e shërbimeve mund t'u caktohen operatorëve të rrjetit ose direkt ofruesit të shërbimeve, kurse në bazë të paragrafit 6 të këtij neni përcaktohet se: Pagesa vjetore për numeracionin e caktuar për operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në emër të shfrytëzimit kryhet nga shfrytëzuesi.

Bazuar në Planin e Numeracionit, nenin 5, paragrafin 4), përcaktohet se periudha kohore e caktimit të numrave jo-gjeografik mobil (seria 4x), është e pakufizuar, përveq nëse nuk është specifikuar ndryshe në vendim të Autoritetit. Neni 8, paragrafi 1) i Planit të Numeracionit specifikon se tarifa vjetore për numeracionin nga seria 4x është 0.06 euro për numër. Më tutje neni 8, paragrafi 2) i Planit të Numeracionit, përcakton se tarifimi për këta numra/blloqe numerike do të bëhet në baza vjetore dhe atë nëntëdhjetë (90) ditë pas përfundimit të vitit fiskal.

Vendimi nr. 381 për Rezervimin e Serisë së Numeracionit Jo-Gjeografik - mobil (0)45 7xx xxx për përdorim të mëtutjeshëm nga Operatori Virtual - Dardafon.Net LLC' (Nr. prot. 026/B/13) është shfuqizohet në tërësi për shkak se tashmë Dardafon.Net LLC do të përdorë numrat nga seria 046 1xx xxx.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të këtij Vendimi.

Prishtinë, 24/ 10/ 2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Telekom i Kosovës Sh.A.
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP
- Departamentit Ligjor, ARKEP dhe
- Arkivit